



VENDIM

Nr. 136, Datë 26.11.2015

**MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 99; 109 pikat 4 dhe 5; 110 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar,

Konstatohet se :

- ERE ka detyrimin e përafrimit të kuadrit ligjor ekzistues me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- Organi i administratës në ushtrimin e funksioneve të tij, e në zbatim të ligjit, Nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, duhet të respektojë parimin e drejtësisë, barazisë dhe proporcionalitetit.
- Në nenin 99 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” parashikohet se “Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.”

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e një ndryshimi në kapitullin IX.1.3 gërma “g” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike me përmbajtjen si më poshtë :

“Duke filluar nga 1 Janari 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, sipas legjislacionit në fuqi.”

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.